

20030491138

L I G J I
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
ME KREDI NË QEVERINË E MBRETËRISË SË SPANJËS SIPAS MARRËVESHJES
PËR KREDI PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "BRANA" ME OBJEKTE
PËRCJELLËSE SI PJESË E SISTEMIT HIDROMELIORATIV "LISIÇE"

Neni 1

Në Ligjin për ngarkimin e Republikës së Maqedonisë me kredi në Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës sipas Marrëveshjes për kredi për realizimin e projektit "Braná" me objektet përcjellëse si pjesë e Sistemit hidromeliorativ "Lisiçe" ("Gazeta zyrtare e Republik[s s[Maqedonis[“ num[r 32/02), në nenin 2 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"30% e kredis[nga neni 1 i këtij ligji është me afat pagimi prej shtat[vjetësh, me grejs periudhë prej 28 muajsh dhe shkallë t[kamat[s variab[l- EURIBOR + 1%."

Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

"Në shumën e kredisë paguhet provizion i njëhersh[m prej 0.15% për pjesën e kredisë me afat të pagimit prej 31 vjetësh me grejs periudhë prej 11 vjetësh, përkatësisht 0.4% për pjesën e kredisë me afat pagimi prej shtat[vjetësh, për udhëheqje me kredinë."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".